



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtorin Ekzekutiv të

Internews-Kosova

Prishtina - Kosova

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Internews Kosova, Prishtinë – Kosovë, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016 dhe 2015, pasqyrën e performancës dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Legjislacionin përkatës për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-134; për Lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare; Ligji NR. 05/L-029; për Tatimin në të Ardhurat në Korporatave.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Legjislacionin përkatës për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-134; për Lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare; Ligji NR. 05/L-029; për Tatimin në të Ardhurat në Korporatave, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.


Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Pasqyra e pozitës financiare me datën 31 dhjetor 2016*(Vlerat në EURO)*


	<u>31-dhjetor-16</u>	<u>31-dhjetor-15</u>
Pasuritë Qarkulluese		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë së gatshme	61,366.97	76,740.65
Te arkëtueshmet nga donatorët	5,795.00	3,640.04
Avanset e paguara Partnerëve	-	7,186.01
	<u>67,161.97</u>	<u>87,566.70</u>
 Pasuritë jo qarkulluese		
Prona pajisjet dhe makineritë	11,921.86	9,147.66
	<u>11,921.86</u>	<u>9,147.66</u>
 Total pasuritë	<u>79,083.83</u>	<u>96,714.36</u>
 Detyrimet dhe balanca e fondeve		
Llogarite e pagueshme	-	17,488.88
Fondet- të hyrat e shtyra	67,161.97	70,077.82
Fondet permanent të restriktuara – Pasuritë jo qarkulluese	11,921.86	9,147.66
Balanca e Fondeve	<u>79,083.83</u>	<u>79,225.48</u>
 Total detyrimet dhe balanca e fondeve	<u>79,083.83</u>	<u>96,714.36</u>

*Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave***Autorizuar nga menaxhimi me**27/03/2017

z. Faik Ispahiu

**Drejtor Ekzekutiv**

Yllka Hoxha

**Përgjegjëse Financiare**

Internews-Kosova

Pasqyra e përfundimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016

(Vlerat në EURO)

	<u>31-dhjetor-16</u>	<u>31-dhjetor-15</u>
TË HYRAT - NGA GRANTET		
Grantet për projekte	354,008.66	360,316.52
Te hyrat nga Qiraja	22,100.00	20,700.00
Total të hyrat	376,108.66	381,016.52
SHPENZIMET		
Shpenzimet e Projekteve	(325,771.32)	(336,547.95)
Paisjet	(7,951.13)	(1,403.00)
Shpenzimet Administrative	(42,386.21)	(43,065.57)
Total Shpenzimet	(376,108.66)	(381,016.52)
TEPRICA E FONDEVE MBI SHPENZIMET	0.00	0.00
TE HYRAT DHE SHPENZIMET TJERA		
Plus: Shtesat e pajisjeve gjat vitit	7,951.13	1,403.00
Minus: Zhvlerësimi	(5,176.93)	(12,001.82)
Total te Hyrat & shpenzimet tjera	2,774.20	(10,598.82)
TEPRICA TE HYRAVE/ SHPENZIMEVE PËR VITIN	2,774.20	(10,598.82)



Internews-Kosova

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën e mbyllur 31 dhjetor 2016

(Vlerat në EURO)

	<u>31-dhjetor-16</u>	<u>31-dhjetor-15</u>
AKTIVITETET OPERATIVE		
Neto e hyrat	2,774.20	(10,598.82)
Rregullimet për barazim të neto të hyrave		
· Zhvlerësimi	5,176.93	12,001.82
· Parapagimet	7,186.01	(7,186.01)
· Llogaritë e arkëtueshme	(2,154.96)	23,652.17
· Llogaritë e pagueshme	(17,488.88)	9,351.97
· Fondet e projekteve	(2,915.85)	(69,990.44)
Neto paraja nga aktivitetet operative	(7,422.55)	(42,769.31)
AKTIVITETET INVESTIVE		
· Pajisjet dhe makineritë	(7,951.13)	(1,403.00)
Neto paraja nga aktivitet Investive	(7,951.13)	(1,403.00)
Neto paraja për periudhën	(15,373.68)	(44,172.31)
Paraja në fillim të periudhës	76,740.65	120,912.96
PARAJA NË FUND TË PERIUDHËS	61,366.97	76,740.65

AL